

VENDIM
Nr. 150, datë 31.10.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE LIGJORE PËR KONTRAKTIMIN E NJË KONSULENTI
LIGJOR QË DO TË ASISTOJË ERE-N NË MOSMARRËVESHJET E KRIJUARA ME
SHOQËRINË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ligjit nr. 10 116, datë 23.4.2009 “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe CEZ a.s.”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 392, datë 8.4.2009 “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit në institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale””, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 31.10.2012, pasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat ligjore për kontraktimin e një zyre juridike me eksperiencë ndërkombëtare, e cila të mbështesë ERE-n me këshillimet e nevojshme juridike në lidhje me mosmarrëveshjet e krijuara me shoqërinë “CEZ Shpërndarje” sh.a.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të marrë të gjitha masat ligjore për realizimin e kësaj procedure.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

NË MUNGESË, ME POROSI
Adriatik Bego